

# coronahilfe.sg

**Kantoni St.Gallen qëllimisht dëshiron të përkrahë persona, që për shkak të pandemisë së koronës janë vënë në vështirësi personale ose financiare. Për këtë qëllim, një ofertë e gjerë me konsultime si dhe përkrahje financiare është në dispozicion.**

## **Kush ka të drejtë për konsultime korone?**

Të gjithë personat, që për shkak të pandemisë së koronës hasin vështirësi personale ose financiare, mund t'i drejtohen një zyre konsultimi në komunë. Në [www.coronahilfe.sg.ch](http://www.coronahilfe.sg.ch) e gjeni zyrën e konsultimit përgjegjëse për komunën tuaj të vendbanimit, të cilën mund të kontaktoni me telefon ose me e-mail.

Pavarësisht nga pandemia e koronës, çdo person, që e ka vendbanimin e tij në Kantonin St.Gallen, ka të drejtë për konsultim në çështje sociale. Një listë për ofertën e përgjithshme të zyrave të konsultimit në çështje sociale e gjeni gjithashtu në [www.coronahilfe.sg.ch](http://www.coronahilfe.sg.ch).

## **Kush ka të drejtë për ndihmë financiare për shkak të koronës?**

Të drejtën për përkrahje financiare e kanë këta persona, që banojnë në Kantonin St.Gallen, të cilët që nga fillimi i pandemisë së koronës kanë më pak të ardhura (p.sh. për shkaqe papunësie ose pune të shkurtuar) dhe kështu nuk mund të mbulojnë më shpenzimet e tyre të jetesës. Gjithashtu ka mundësi të merrni ndihma financiare korone, nëse tashme po merrni pagesa nga sigurimi shoqëror (p.sh. shpërblim papunësie ose shpërblime sipas rregullores Corona-EO).

## **Kush nuk ka të drejtë për ndihmë financiare për shkak të koronës?**

Persona, që në momentin e parashtrimit të kërkesës nuk banojnë në Kantonin St.Gallen, nuk kanë të drejtë për ndihmë financiare për shkak të koronës. Edhe persona, që marrin ndihmë sociale dhe persona, që marrin një pension AHV ose IV, nuk kanë të drejtë. Gjithashtu këta persona nuk kanë të drejtë, pasuria e të cilëve tejkalon një vlerë të caktuar kufitare (person individual Fr. 4'000.–, çift martesor/çift në bashkëjetesë Fr. 8'000.– duke shtuar për çdo fëmijë Fr. 2'000.–, si familje jo më shumë se Fr. 10'000.–).

## **Si dhe ku mund të parashtroni kërkesë për ndihma financiare për shkak të koronës?**

Ju mund ta parashtroni kërkesën tuaj në rrugë elektronike ose si shkresë e printuar pranë zyrës për çështje sociale në komunën tuaj të vendbanimit. Formularin e kërkesës e gjeni në [www.coronahilfe.sg.ch](http://www.coronahilfe.sg.ch).

## **Çka duhet të dini rreth ndihmës financiare për shkak të koronës?**

Ndihma financiare për shkak të koronës...

- i zvogëlon humbjet e të ardhurave, që u shkaktuan nga pandemia.
- nuk duhet të kthehet.
- nuk ka ndikime në statusin tuaj të qëndrimit.
- është e tatueshme.

## Pyetje të shpeshta

### Ku mund ta parashtroni kërkesën tuaj online?

- Ju mund ta parashtroni kërkesën tuaj online
- Ju mund ta dorëzoni kërkesën tuaj si shkresë e printuar pranë zyrës për çështje sociale të komunës së vendbanimit tuaj
- Ju mund ta plotësoni dhe dorëzoni formularin e kërkesës me ndihmën e zyrave të konsultimit, që janë përgjegjëse për komunën tuaj të vendbanimit.

### Si llogaritet e drejta ime për ndihmë financiare për shkak të koronës?

Me qëllim që të shqyrtohet, nëse keni të drejtë për ndihmë financiare për shkak të koronës, me anë të formularit të koronës dhe të dokumenteve të parashtruara nga ana juaj bilancohen shpenzimet tuaja të miratuara (nevoja për jetesën, qira, shpenzime pune, etj.) me të ardhurat tuaja të llogaritshme (rroga, shtesa për fëmijë, pensione ushqimore, etj.). Nëse nga ky bilancim rezulton një deficit, ju në çdo rast keni të drejtë për ndihmë financiare për shkak të koronës si shpërblim për humbjet tuaja të të ardhurave. Me interes janë 12 muajt e fundit para parashtrimit të kërkesës.

### Unë marr ndihmë sociale. A mund të parashtroni kërkesë për ndihmë financiare për shkak të koronës?

Jo. Marrësit e ndihmës sociale nuk bëjnë pjesë në grupin e personave, që kanë këtë të drejtë. Ndhma financiare për shkak të koronës është një instrument plotësues për sistemin ekzistues të sigurimit social.

### Unë marr një pension AHV ose IV dhe gjithashtu kam humbje të ardhurash. A mund të parashtroni kërkesë për ndihmë financiare për shkak të koronës?

Jo. Ju si marrës të një pensioni AHV ose IV vetëm keni të drejtë për pagesa plotësuese, nëse shpenzimet tuaja të llogaritshme i tejkalojnë të ardhurat tuaja të miratuara. Për një rast të tillë, ju lutemi drejtohuni drejtpërsëdrejti institucionit të sigurimit shoqëror të Kantonit St.Gallen. [www.svasg.ch/produkte/el/](http://www.svasg.ch/produkte/el/)

### Jam vetëpunësuar. A mund të parashtroni kërkesë për ndihmë financiare për shkak të koronës?

Ndhma financiare për shkak të koronës synohet vetëm për situata personale në nevojë. Nëse ju si i/e vetëpunësuar/a pësoni humbje (humbje rroge) për shkak të masave të koronës, që janë në fuqi, ju si person privat keni të drejtë për ndihmë financiare për shkak të koronës. Një përkrahje e mëtejshme për kompaninë tuaj nuk mund të jepet nga ndhma financiare për shkak të koronës. Informata të detajuara për përkrahjen e rasteve të rënda në Kantonin St.Gallen i gjeni këtu:

[Kantonale Härtefallmassnahmen | sg.ch](http://Kantonale_Haerterfallmassnahmen_sg.ch)

### Jam pronar/e shtëpie. A më llogaritet prona si pasuri?

Jo. Pasuri quhen vetëm këto asete, që mund të likuidohen afatshkurtër, si para kesh ose edhe aksione. Kapital i depozituar afatgjatë ose asete të tjera të lidhura si pasuri të paluajtshme nuk llogariten.

### Në muajt e fundit mund të paguaja të gjitha faturat e mija, por vetëm sepse mora para borxh nga të afërmit e mi. Pavarësisht nga ky fakt, a mund të parashtroni kërkesë për ndihmë financiare për shkak të koronës?

Po. E drejta për ndihmë financiare për shkak të koronës llogaritet në bazë të të ardhurave tuaja dhe të shpenzimeve tuaja të llogaritshme. Para të marra borxh nuk konsiderohen si të ardhura.

### Unë kam marrë ndihmë për shkak të kovidit si person, që punon në fushën e kulturës. Pavarësisht nga ky fakt, a mund të parashtroni kërkesë për ndihmë financiare për shkak të koronës?

Po. Megjithatë shuma të tjera të mbështetjes nga shteti ose nga organizata ndihmëse konsiderohen si të ardhura në llogaritjen e së drejtës për ndihma financiare për shkak të koronës. Nëse të ardhurat tuaja të miratuara me të gjitha shumatat e mbështetjes së marrë nuk i mbulojnë shpenzimet tuaja të llogaritshme, ju në çdo rast keni të drejtë për ndihmë financiare për shkak të koronës. Më shumë informata për shumatat mbështetjeje në fushën e kulturës i gjeni këtu: [Coronavirus | sg.ch](http://Coronavirus_sg.ch)

### Ç'oferta të tjera ndihmëse në lidhje me koronën ekzistojnë në Kantonin St.Gallen?

Më shumë informata për këtë pyetje i gjeni në kolonën e majtë në [www.coronahilfe.sg.ch](http://www.coronahilfe.sg.ch).